



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 21
Prishtinë, më 30 qershor 2011 dhe 4 korrik 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 30 QERSHOR DHE 4 KORRIK 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kryetari njoftoi Kuvendin për zëvendësimin e deputetit nga subjekti politik Koalicioni për Kosovë të Re, Ibrahim Makolli, për shkak të shkuarjes në detyrë të re, me deputetin Emin Gërbeshi. Ai i dëshiroi punë të mbarë deputetit Gërbeshi dhe e ftoi që ta nënshkruaj deklaratën e betimit.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 23.06.2011,
4. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Ndihmës Juridike,
10. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit ad-hoc parlamentar për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Ismet Beqiri, Berat Buzhala, Glauk Konjufca, Skënder Hyseni, Xhevahire Izmaku, Myzejene Selmani, Liburn Aliu, Hashim Dëshishku dhe Zenun Pajaziti. Diskutimet e tyre të plota janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, nuk e parashtroi pyetjen në mungesë të zv.kryeministres Mimoza Kusari- Lila.

Deputeti, Goran Marinković, nuk ishte i pranishëm në sallë për ta parashtruar pyetjen për ministrin Besim Beqaj.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 23 qershor 2011

Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 23 qershor 2011, pa vërejtje.

4. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryetari i njoftoi deputetët për kohën e interpelancës, që do zgjasë 3 orë, prej së cilës pozita ka 90 minuta, minus 15 minuta për kryeministrin, opozita ka 78 minuta, si dhe deputetët pa grupe parlamentare kanë 12 minuta.

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka parashtruar kërkesë për interpelancë të Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me kontratën e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe konzorciumit Bechtel & Enka për autostradën Morinë -Merdar.

Ai ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, **Visar Ymeri**, tha se janë bërë tashmë një vit e dy muaj që kur është nënshkruar kontrata mes Qeverisë së Kosovës dhe konzorciumit Bechtel & Enka për ndërtimin e auto - udhës Morinë – Merdar.

Ky projekt, i cili pa dyshim se është investimi më i madh kapital i Kosovës në këto 12 vitet e fundit, nuk dihet saktësisht se sa do të kushtojë. Në këtë Kuvend, kryeministri Hashim Thaçi pati deklaruar se ajo do të kushtojë diku rreth 700 milionë, ndërkohë që

përmes mediave ministri i Financave e ka dhënë një shumë tjetër prej gjithsej 1 miliard eurosh, sigurisht duke kalkuluar kështu edhe koston e shpronësimit, ndërkaq kontrata e nënshkruar nuk jep kurrfarë kostoje definitive. Atë kontratë ne ua kemi shpërndarë të gjithëve dhe besoj që e keni përpara dhe e keni lexuar.

Vendimi që përfundimisht të shkohet me Bechtel & Enka dhe që të nisë ndërtimi i auto-udhës në këtë kohë, është tejet e dyshimtë. Së pari, nguta për të filluar punën në auto-udhë, pa i siguruar mjetet financiare për një projekt të tillë, pa e ditur as koston, as trasenë e madje as dizajnin e rrugës, nuk i ka konvnuar fare Kosovës.

Në dokumentin vlerësues të kompanisë Eversheds, të kontraktuar nga Qeveria e Kosovës për ta vlerësuar kontratën e propozuar nga Bechtel & Enka, përmendet vazhdimisht kostoja e planifikuar rreth 400 milionë euro. Pra, a ka qenë plani fillestar që rruga të kushtojë vetëm 400 milionë euro dhe, nëse po, atëherë si u bë që kjo kosto u dyfishua në kontratën përfundimtare?

Çmimet e vetme që jepen në tekstin e mëtejshëm të kontratës janë çmimet për njësi dhe një vlerësim i synuar i çmimeve për sektorë. Kontrata ia lejon kontraktorit që për secilin sektorë të rrugës, 9 sish sa janë gjithsej në këtë projekt, ta rrisë koston e paraparë për 20%, sepse Bechtel & Enka me kontratë e fiton të drejtën ta fillojë punën menjëherë në sektorin 1 dhe 2. Këtu, Qeveria e Kosovës nuk ia ka lënë vetes fare mundësinë të ndërhyjë në ngadalësimin e punës për t'ia përshtatur atë aftësisë financiare të buxhetit për t'i bartur kostot e projektit, pra që ne duhet të paguajmë, pavarësisht nëse kemi para apo jo.

Në kontratë specifikohet se nëse punët në projekt zgjasin më shumë se 3 vjet, atëherë koston së punëve i shtohet edhe një 12%, si mbulesë për inflacion që në vitin e parë, për të vazhduar me nga 4% inflacion në vitet tjera.

Presim nga kryeministri të na tregojë se sa kanë kushtuar dy sektorët e parë dhe a i kanë tejkaluar ato 120% të lejuara me kontratë?

Kontrata është nënshkruar me kompaninë Bechtel & Enka pa e pasur të definuar saktë trasenë, pa e pasur dizajnin e rrugës, si dhe pa i bërë paraprakisht një vlerësim gjeologjik vendit ku ajo do të ndërtohet. Të gjitha këto elemente kanë mundësi t'ia shtojnë koston projektit, sepse traseja e rrugës, dizajni i saj, si dhe vlerësimi gjeologjik i tokës ku do të ndërtohet ajo e përcaktojnë pak a shumë edhe sasinë e materialit ndërtues që duhet përdorur aty.

Projekti ka filluar të ndërtohet dhe ka ardhur në fazën përfundimtare të tij në 37 kilometrat e parë dhe vetëm tash Qeveria e Kosovës e ka kontraktuar një kompani mbikëqyrëse të punës.

Kryetari ftoi kryeministrin e Kosovës ta marrë fjalën.

Kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi**, falënderoi deputetët e subjekteve të caktuara politike të cilët kanë kërkuar këtë interpelancë për të diskutuar për projektin më madhor infrastrukturor që ndonjëherë ka ndërtuar Kosova.

Unë mund t'ju konfirmoj se dinamika e deritanishme tregon një punë rekorde, e cila në segmente të caktuara të autostradës arrin pikën e realizimit të punimeve deri në 12 muaj para afatit.

Qeveria e Republikës së Kosovës respekton plotësisht kontratën me konzorciumin Bechtel & Enka, përfshirë edhe nenin përkatës të kontratës që specifikon konfidencialitetin dhe mbrojtjen e biznesit të kontraktuesit, në pajtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare në këtë fushë.

Draft-kontrata e prezantuar aty - këtu, se gjëja është zbuluar, është një manipulim me opinionin publik. Cilado palë e interesuar ka pasur mundësi që të kërkojë qasje në dokumentin zyrtar, sipas ligjeve në fuqi, dhe institucionet kompetente e kanë theksuar se kontrata finale mund të shihet, të studiohet, por nuk mund të bëhen kopje të saj për shkak të limitimeve të sipër cekura.

Ky projekt madhor kontribuon në zhvillimin e ekonomisë përmes përdorimit të burimeve vendore, përdorimin e nënkontraktorëve vendorë dhe punësimin direkt të qytetarëve të Kosovës. Momentalisht, rreth 3100 punonjës janë të angazhuar në projektin, nga të cilët 68% janë punëtorë lokalë.

Është një projekt integruar, që Kosovës dhe qytetarëve të saj do t'ju ofrojë mundësitë më të mira për qarkullimin e lirë të njerëzve dhe të kapitalit.

Procesi i ndërtimit të autostradës ka qenë procesi më transparent i mundshëm, për të cilin ka pasur një konkurrencë të hapur, ku kanë konkurruar 7 kompani dhe konzorciume me renome globale dhe ku procesi i vlerësimit, i udhëhequr nga kompania Eversheds, ka rezultuar zgjedhjen e konzorciumit Bechtel & Enka, si ofertuesi më i mirë, më i lirë dhe më i favorshëm për Kosovën.

Pas këtij procesi, grupi ndërmarrës e ka negociuar kontratën finale me kontraktuesin e përzgjedhur gjatë një periudhe të gjatë dhe ka arritur të finalizojë një kontratë shumë të favorshme në interes të vendit dhe të qytetarëve. Gjithë këtë proces e kanë përcjellë nga afër Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Komisioni Evropian dhe USAID-i dhe është vlerësuar nga të gjithë faktorët ndërkombëtarë.

Autostrada Morinë – Merdar do të jetë autostradë e kualitetit më të lartë, jo vetëm në Kosovë, por në gjithë rajonin. Transparenca financiare e projektit është e plotë dhe të gjitha shpenzimet deri në detajin më të vogël janë të përfshira në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, në ligjet përkatëse për buxhetin, si dhe në raportet periodike për shpenzime të cilat bëhen publike.

Çmimi që është përfshirë në kontratën e autostradës është çmim gjithëpërfshirës që mbulon shpenzimet e prodhimit, shpenzimet e objekteve prodhuese, dërgimin e prodhimit final, formësimin e tij, vendosjen në vendet e caktuara, mjetet përcjellëse për vendosje, skelerinë, pajisjet për kryerjen e punimeve të betonit, programin për verifikimin e cilësisë, aspektet e sigurisë, testimin e prodhimit final e tjerë. Pra, nuk mund të krahasohet vetëm një element i koston me koston e përgjithshme.

Në fund, mund të konfirmoj se Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të jetë krejtësisht transparente, duke respektuar të gjitha dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si për

projektin e autostradës, po ashtu edhe për të gjitha projekt tjera kapitale të cilat janë në shërbim të zhvillimit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe të përmirësimit të jetës së qytetarëve tanë.

Pastaj, kryetari hapi diskutimin lidhur me interpelancën e kryeministrit Hashim Thaçi.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të KKR-së, tha se autostrada “Ibrahim Rugova”, si projekt ka filluar në mandatin e kaluar dhe ne nuk jemi kundër ndërtimit të saj, kur dihet se autostrada është një aset i cili i ndihmon zhvillimit ekonomik. Është mirë që të debatohet në Kuvendin e Kosovës çështja e financimit të saj për arsye se projekti për autostradën ndërtohet me paratë e buxhetit të Kosovës.

Blerim Shala, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se nuk ka autostradë Vërmicë – Merdar. Kontrata e nënshkruar midis Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe konzorciumit Bechtel & Enka vlen për vijën Vërmicë – Prishtinë e jo Vërmicë – Merdar. Ekziston projekti i autostradës, por nuk ekziston kontrata e cila e specifikon deri në detale rrugën Vërmicë – Merdar.

Tema që ka të bëjë me çmimin e autostradës, sipas Marrëveshjes stand-by midis Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (në faqen 25) të nënshkruar në korrikun e vitit të kaluar, autostrada Vërmicë – Prishtinë do të kushtojë 1 miliard e 4 milionë euro.

Në stand-by aranzhmanin e Qeverisë së Kosovës me FMN-në, vetë Qeveria e Kosovës thekson që për shkak edhe të ndërtimit të autostradës do të ndodhë përkeqësimi i madh i stabilitetit financiar të Kosovës. Projektet e tilla kapitale realizohen në forma të tjera, e jo me paratë që merren nga buxheti i Kosovës.

Jemi të sigurt që nuk kanë pasur vendimmarrje të duhur dhe transparente se në ç’mënyrë duhet të ndërtohet autostrada në fjalë, për të cilën gjithmonë qysh nga vitet ’90, qysh nga koha kur presidenti Rugova i ndjerë e shpalli këtë interes, ka qenë interes i gjithë Kosovës dhe i gjithë kombit.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, tha se Lëvizja “Vetëvendosje e thekson shumë qartë se jo vetëm ne, por asnjë shqiptarë që e do kombin e vet nuk mund të jetë kundër ndërtimit të një auto-udhe që e lidhë Kosovën me Shqipërinë. Ajo me çka kemi ne problem, nuk është autostrada, po kontrata.

Sa i përket kontratës, ne dyshojmë se kontrata e lidhur për autostradën në fjalë e mbingarkon financiarisht në mënyrë krejt të paarsyeshme shtetin e Kosovës. Ne mendojmë se kontrata me Bechtel & Enka është shumë e njëanshme. Kosova i merr mbi supet të gjitha dështimet e kompanisë, kurse Bechtel & Enka i merr të gjitha përfitimet e mundshme. Ne themi se kontrata me Bechtel & Enka është thjeshtë e pafavorshme, ky është thelbi i diskutimit tonë.

I bëjmë thirrje Qeverisë që të mos e keqpërdor kombin, por t’i japë llogari kombit për veprimet e veta të dëmshme. Sa i përket transparencës, kryeministri po ashtu ka thënë se kontratën mund ta marrë çdo kush. Në fakt, dy organizata joqeveritare: organizata joqeveritar GAP dhe Lëvizja “Fol”, sidomos kjo e fundit e ka dërguar Qeverinë në

gjykatë për arsye se nuk ka mund ta marrë kontratën të cilën ju keni thënë se mund ta marrë gjithkush.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, tha se LDK konsideron se ky projekt është i një rëndësie të veçantë nacionale dhe më gjerë. Por, ky projekt madhor për Kosovën dhe më gjerë filloi të shndërrohet, megjithatë, në një projekt të mistershëm, sekret për shumëçka. Ne edhe më herët kemi shfaqur shqetësimin për rrjedhën e realizimit të këtij projekti.

Ministria e Transportit ka nënshkruar një kontratë me kompaninë BPI CONSUL GMBH, qershor 2004, për realizimin e shërbimeve inxhinierike për projektimin e autostradës Morinë-Merdar dhe kompania në fjalë ka përfunduar projektin dhe e ka dorëzuar atë më 17 tetor 2005.

Ajo që për ne si deputetë dhe për qytetarët është e rëndësishme, sepse këto nuk i dimë më vonë, ka përbërë, mes tjerash përbën: përshkrimin e projektit, objektivat e trafikut, qëllimet regjionale të planifikimit, pozitën e rrjetit rrugor, rëndësinë dhe në planifikimin regjional, nyjet rrugore, përshkrimin e përgjithshëm të studimit, të projektimit, optimalizimin, studimin e fizibilitetit të kryer dhe të përfunduar në dhjetor, saktësisht më 25 dhjetor 2006, nga kompania daneze KOV.

Është kështu apo jo, le të tregojnë qeveritarët, faza e projektimit, traseja, identifikimi i trasesë, legjislacioni, financimi e tjera. Këto janë disa nga pjesët dhe çështjet që kanë të bëjnë me projektin e autostradës. Pyes, kush prej nesh i ka ditur ose i di këto përmbajtje për të shkuar tutje drejt shtrimit të çështjeve dhe dilemave tjera, që kanë të bëjnë me atë se cili është tani projekti i vërtetë, ky i miratuar më herët, apo një tjetër? Kuptohet se kemi ndërrim të këtij, të atij projekti, në mos për asgjë tjetër, me ndërrimin e një pjese të trasesë, që edhe sot e konsiderojmë veprim joligjor të Qeverisë dhe besojmë në ndryshimin e çmimit.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës thekson edhe njëherë se ndërtimi i autostradës “Ibrahim Rugova”, vazhdon të realizohet me shumë të panjohura, dilema, dyshime, vazhdon të jetë projekt jotransparent.

(Kryeministri Hashim Thaçi dhe kryetari i GP të LDK-së, Ismet Beqiri, replikuan disa herë)

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se mbështesin debatin për interpelancë lidhur me projektin me kapital për qytetarët e vendit.

Ne, parimisht nuk jemi për politizim të projekteve jetike që prekin direkt zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos projektet që prekin qytetarët e vendit prej të cilave kanë përfitime direkte në realizimin e tyre.

Kosova po realizon një ëndërr të saj të kamotshme, e cila nënkupton krijimin e një shteti të ri modern.

Projekti i cili ka filluar me ndërtimin e autostradës Vërmicë –Merdar, i financiar direkt nga taksapaguesit kosovar, padyshim është projekti më i favorshëm që ka bërë Kosova ndonjëherë në historinë e saj .

Duke bërë projektin më të favorshëm edhe për rajonin, këtë projekt e kanë mbështetur vazhdimisht miqtë tanë ndërkombëtarë, duke ditur rëndësinë e këtij projekti që ka për zhvillimin politik dhe ekonomik të vendit. Punimet që po bëhen në këtë projekt, nga kompania amerikano-turke Bechtel&Enka, nuk do të kishin mundësi të realizoheshin me sukses pa vendosmërinë tonë për ndërtimin e shtetit modern.

Ne, si Grup Parlamentar, jemi për transparencë, jo vetëm në këtë rast konkret, por për të gjitha rastet e mundshme, por kurrsesi nuk jemi që në emër të transparencës të ndërpriten apo të kërkohet dhe të pengohet realizimi i projekteve me interes nacional.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur interpelancën e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi lidhur me kontratën e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe konzorciumit Bechtel&Enka për autostradën Morinë -Merdar dhanë edhe këta deputetë: Rexhep Selimi, Fatmir Limaj, Amir Ahmeti, kryeministri Hashim Thaqi, Ismet Beqiri, Idriz Vehapi, Liburn Aliu, ministri Fehmi Mujota, Teuta Haxhiu, Armend Zemaj, Afrim Kasolli, Hashim Deshishku, Florin Krasniqi, Berat Buzhala, Sabri Hamiti, Ramiz Lladrovci dhe ministri Bedri Hamza.

Diskutimet e plota të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve janë dhënë në Transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Në përfundim të këtyre diskutimeve, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi dha sqarime dhe paraqiti qëndrimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me kontratën e Qeverisë së Kosovës dhe të konzorciumit Bechtel&Enka për autostradën Morinë -Merdarë .

Në fund, në emër të propozuesit të interpelancës, deputeti Visar Ymeri paraqiti tekstin e Mocionit, i përbërë prej katër pikave, për miratim.

Kryesuesi hodhi në votim tekstin e Mocionit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 19,
Kundër-----31,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi Mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Kontratën e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të konzorciumit Bechtel&Enka për ndërtimin e autostradës Morinë –Merdar.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për dizajnin industrial.

Ministri **Blerand Stavileci**, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se Projektligji për dizajnin industrial përcakton kushtet për mbrojtjen e dizajnit industrial: fitimin, vëllimin dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes, të drejtat ekskluzive, procedurat për regjistrimin, ndryshimin, vazhdimin, përfundimin e vlefshmërisë dhe anulimin e së drejtës së dizajnit, mbrojtjen juridiko-civile dhe regjistrimin ndërkombëtar.

Në vazhdim, ministri Blerand Stavileci tha se ky ligj do të zbatohet për të gjitha dizajnet industriale të cilat i nënshtrohen procedurës së regjistrimit në Zyrën për Pronësi Industriale, përfshirë dizajnet komunitare dhe regjistrimet ndërkombëtare të dizajnit të cilat vlejnë në Republikën e Kosovës.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për dizajnin industrial.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavleviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në mungesë të kuorumit, kryesuesi e shtyu votimin e këtij projektligji për më vonë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për patenta.

Ministri **Blerand Stavileci**, tha se Projektligji për patenta përcakton kushtet për mbrojtjen e shpikjeve me anë të patentës: njohjen, vëllimin dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes, të drejtat ekskluzive, procedurat për regjistrimin, ndryshimin, vazhdimin, zbatimin e të drejtave të patentës, përfundimin e vlefshmërisë dhe anulimin e patentës.

Në vazhdim, ministri Blerand Stavileci tha se ligjin që momentalisht është në fuqi e kanë përcjellë disa mangësi dhe mbi këtë bazë ka lindur nevoja që të hartohet ky projektligj i ri, i cili është në harmoni me aktet më të larta ligjore të BE-së. Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për patenta.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavleviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në mungesë të kuorumit, votimi i këtij projektligji e shtyu për më vonë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Ministri **Bajram Rexhepi**, tha se ligji ekzistues nr. 02/L-68 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera ka një numër të zbrastësirave juridike dhe gjatë zbatimit në praktikë ka hasur në disa pengesa.

Në vazhdim, ministri Rexhepi tha se ky projektligj ka për qëllim mbrojtjen e njerëzve, të kafshëve, të pronave, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Më tutje, ai shtoi se organet shtetërore janë përgjegjëse për organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si sistem unik dhe integral shtetëror, ndërsa ky sistem unik përmban programimin, planifikimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe financimin e masave dhe të aktiviteteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në mungesë të kuorumit, votimi i këtij projektligji e shtyu për më vonë.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për markat tregtare.

Ministri **Blerand Stavileci**, tha se Projektligji për markat tregtare rregullon kushtet dhe procedurat për regjistrimin e markave tregtare, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave.

Në vazhdim, ministri Blerand Stavileci tha se Ligji për markat tregtare do të zbatohet për subjektet të cilat i nënshtrohen procedurës së regjistrimit për fitimin e markës tregtare në Zyrën e Pronësisë Industriale të Republikës së Kosovës, e cila funksionon në kuadër të ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të eliminohen mangësitë ekzistuese të cilat e përcjellin këtë fushë.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për markat tregtare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, dhe deputeti, Hashim Deshishku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në mungesë të kuorumit, votimi i këtij projektligji e shtyu për më vonë.

9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Ndihmës Juridike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe komisionet e përhershme kanë shqyrtuar Raportin vjetor të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2010, dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratim e tij.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Enis Kervan, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në mungesë të kuorumit, votimi i këtij raporti u shtyu për më vonë.

Kryesuesi, për mungesë të kuorumit për t’i votuar projektligjet e shqyrtuara, mbylli punimet e mbledhjes së sotme, për t’i vazhduar punimet të hënën, më 4 korrik 2011.

E hënë, më 4 korrik 2011, në orën 10:00

Vazhdim i mbledhjes plenare

Kryetari i njoftoi deputetët se katër projektligjet e shqyrtuara në mbledhjen plenare, të mbajtur më 30 qershor 2011, nuk janë votuar për mungesë të kuorumit. Debati lidhur me shqyrtimin e këtyre projektligjeve ka përfunduar, ndërsa në mbledhjen e sotme duhet vetëm të votohen.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, propozoi që pika fundit-Rekomandimi i Komisionit ad-hoc, për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, ose të votohen të gjithë kandidatët, tetë veta, ose kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Kryetari kërkoi mendimin e kryetarëve të grupeve të tjera parlamentare lidhur me këtë propozim.

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetari hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të LDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----shumica absolute,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi vendosi që Rekomandimi i Komisionit ad-hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, të shtyhet për mbledhjen tjetër të radhës.

- Votimi në parim i Projektligjit për dizajnin industrial

Kryetari hodhi në votim miratimin, në parim, të Projektligjit për dizajnin industrial. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 88,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për dizajnin industrial.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi në parim i Projektligjit për patenta

Kryetari hodhi në votim miratimin, në parim, të Projektligjit për patenta. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 84,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për patenta.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 91,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi në parim i Projektligjit për markat tregtare

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 87,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për markat tregtare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi i Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 85,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Raportin e punës të Komisionit për Ndihmë Juridike.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare të Kuvendit, në orën 10:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale